



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 549/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.08.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “AN & RA” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-20011-04-30-2019, me objekt: “Blerje materiale të buta dhe dyshekë për fëmijë”, me fond limit 20,937,512.55 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Malbertex” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “AN & RA” sh.p.k
Adresa: Kutia Postare nr.79, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë
Adresa: Rr. “Barrikadave”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 02.05.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-20011-04-30-2019, me objekt: “*Blerje materiale të buta dhe dyshekë për fëmijë*”, me fond limit 20,937,512.55 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë.

II.2 Në datën 03.06.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 11.06.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. ”Atlantik 3” sh.p.k.	pa ofertë ekonomike, Skualifikuar;
2. ”Shaga” sh.p.k.	18,000,000 lekë, Skualifikuar;
3. “AN & RA” sh.p.k.	19,635,000 lekë, Skualifikuar;
4. “Malbertex” sh.p.k.	19,770,000 lekë, Kualifikuar;
5. “Euro 2001” sh.p.k.	20,865,000 lekë, Skualifikuar;

II.4.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorin ekonomik “AN & RA” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“Kriteret e veçanta pika 2.3.7, operatori ekonomik nuk e përmbush plotësimin e këtij kriteri. Operatori duhet të paraqiste për subjektin “4 Vëllezërit” me të cilin do të realizonte furnizimin me çarçafë, dokumentacionin i cili të vëtetonte ligjshmërinë e veprimtarisë së këtij subjekti për mallrat objekt i këtij prokurimi dhe jo vetëm autorizim për paraqitje oferte.

1.2 Kriteret e veçanta pika 2.3.9, 2.3.10 operatori ekonomik nuk ka dorëzuar mostrat sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor për artikujt e kërkuar: 1.2.1 Artikulli “dyshek krevati për fëmijë” - Është konstatuar se mbi dyshekun e paraqitur si mostër nuk ka asgjë të shënuar, stampim apo etiketim (me qepje) nga prodhuesi, ku të vërtetohet se ky dyshek është prodhim i prodhuesit “DEA” shpk. - Për artikullin e paraqitur si mostër, OE nuk ka paraqitur “Skedën teknike” (orgjinale apo fotokopje të noterizuar) sikurse kërkohet në dokumentat e tenderit, duke deklaruar se e ka paraqitur atë në sistemin elektronik. - Nga ana e KVO, komisionit për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave i është vënë në dispozicion “Skeda teknike” e prodhuesit, e paraqitur në sistemin elektronik nga OE. - Komisioni për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave, konstaton se “Skeda teknike” e paraqitur është lëshuar nga prodhuesi “Dea” shpk. - Në skedën teknike të paraqitur janë përshkruar: Përmasat e shtresave të dyshekut dhe parametrat e copës së përdorur. - Për arsye se dysheku i paraqitur si mostër nuk ka asnjë shenjë dalluese që të vërtetojë se është produkt i prodhuesit “Dea” shpk, skeda teknike e paraqitur nuk mund të merret në konsideratë nga komisioni për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave. - Për artikullin e paraqitur si mostër, OE ka paraqitur një Katalog (në origjinal) të prodhuesit të dyshekëve “Dea sleep”. Në këtë katalog paraqiten një seri fotosh dyshekësh krevati me emërtime të ndryshme (Fiora, Elegant, Confort, Brillant, Rubin, Elasso, Prestige, Smerald, Hamburg, Bremen, Vip, Imperial, Geneva, Magic, Vanity dhe Majesty), por asnjëri nga dyshekët e katalogut nuk përputhet me të dhënat e dyshekut të kërkuar dhe dyshekun e paraqitur si mostër. - Nuk ka asnjë shenjë dalluese që të vërtetojë se mostra e paraqitur ka lidhje me katalogun e paraqitur. - Për këtë arsye katalogu i paraqitur nuk mund të merret në konsideratë nga komisioni për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave. Për “Materialin veshës të dyshekut”, OE nuk ka paraqitur “Dokumentin e miratimit nga institucione të akredituara dhe të jetë e certifikuar OEKO-TEX “Lista e Bardhe” Standard 100 per bebe ose ekuivalente me të”. (orgjinale apo fotokopje të noterizuar) sikurse kërkohet në dokumentat e tenderit, duke deklaruar se e ka paraqitur atë në sistemin elektronik. Nga ana e KVO, komisionit për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave, i është vënë në dispozicion Çertifikata “OEKO-TEX STANDARD 100”, e prodhuesit “Dea” shpk, me nr. 1807066, e lëshuar nga “Centexbel” Technologiepak7, Begjikë, e vlefshme deri më 31.07.2019, e paraqitur në sistemin elektronik nga OE, “AN&RA” shpk. Për arsye se dysheku i paraqitur si mostër nuk ka asnjë shenjë dalluese që të vërtetojë se është produkt i prodhuesit “Dea” shpk, Çertifikata “OEKO-TEX STANDARD 100”, e prodhuesit “Dea” shpk, e paraqitur nuk mund të merret në konsideratë nga komisioni për verifikimin, inspektimin dhe marrjen në dorëzim të mostrave. Për “Materialin veshës të dyshekut”, OE nuk ka paraqitur “Deklaratë konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë” duke deklaruar se i ka paraqitur ato në sistemin elektronik. Pas verifikimit në sistemin elektronik, nga ana e KVO konstatohet se OE nuk ka paraqitur “Deklaratë konformiteti”. Për “Strukturën e brendshme të dyshekut”, OE nuk ka paraqitur “Deklaratë konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë” duke deklaruar se i ka paraqitur ato në sistemin elektronik. Pas verifikimit në sistemin elektronik, nga ana e KVO konstatohet se OE nuk ka paraqitur “Deklaratë

konformiteti” Për “Këllëfin e jashtëm të dyshekut”, OE nuk ka paraqitur “Deklaratë konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë” duke deklaruar se i ka paraqitur ato në sistemin elektronik. Pas verifikimit në sistemin elektronik, nga ana e KVO konstatohet se OE nuk ka paraqitur “Deklaratë konformiteti” Duke analizuar të dhënat e mostrës së paraqitur dhe dokumentacionin”

II.5.Në datën 17.06.2019, operatori ekonomik “AN & RA” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe duke ngritur pretendime mbi ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Malbertex” sh.p.k. në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1481/5 Prot. datë 19.06.2019, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “AN & RA” sh.p.k, duke mos e pranuar ankesën e paraqitur prej tij.

II.7.Në datën 28.06.2019, operatori ekonomik ”AN & RA” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Ndersa ne kemi te gjithë dokumentacionin e kerkuar ne DST, keta futen ne arsyetime se nga te dime ne te bejme lidhjen mes ofertesit e prodhuesit, se nuk eshte e stampuar copa e dyshekut. (ku te gjitha gjera tjane te qarta); nga ana tjetere OE i kualifikuar ka dokumentacion te munguar dhe vleresohet se i ploteson te gjitha kriteret e kerkuara nga AK.nderkohe qe :

I mungon Flete analiza per copen e leshte te dyshekut.

Stampimin ne dyshek si prodhues e ka te subjektit te tij “Malbertex” Shpk, nderkohe nuk zoteron Certifikaten Oeko-tex (Ka paraqitur nje autorizim nga nje firme turke: Merketeks-Tekstil san.tic.ltc.sti, te ciles edhe ketij subjekti i ka mbaruar afati qe me date 30.04.2019. Per me Shume info : Vendimi K.P.P. 262/2019 (nr. 553 date 28.03.2019). Kjo eshte lehtesisht e dallueshme nga Proces-verbali i KVO-se, gjate marrjes se mostrave ne dorezim. (Po ja bashkangjes ketij ankimi) Ndaj ne kerkojme skualifikimin e ketij subjekti (I cili ka 3 vite rrjesht qe eshte furnitor ne kete institucion; e ndersa vet ka mangesi te pa tolerueshme, ushtron ndikim te paligjshem ne KVO e AK, nga njohjet e krijuara, per te hequr OE me oferte me te ulet se e Tij).

Se dyti:Po marrim nje e nga nje arsyetimin e A.K. qe arrijne ne skualifikimin tone.

I. KVO-ja thote se per carcafet, qe ne kemi paraqitur autorizim nga Subjekti “4 Vellezerit” shpk, por sipas tyre, nuk kemi paraqitur dokumentacion per ligishmerin e prodhuesit. Subjekti “4 Vellezerit” nuk eshte ofertues apo bashkim OE me subjektin tone “AN & RA ” shpk ne kete procedure, qe ne te paraqesim dokumente ligjore per kete subjekt. Ai thjeshte na suporton ne si prodhues carcafesh qe eshte, qe na pergjigjet ne afat dhe cilesi sipas kerkeses tone per te permbushur kontraten; megjithese ne kemi realizuar kontrata dhe me te medha se kjo e AK-se (shiko ne sistem elektronik), me afat 3 here me te shpejte se e kerkon AK dhe pa ndonje suport nga ndonje Subjekt. Autorizimi mbane Emrin e subjektit, Adresen, NIPT-in dhe lehtesisht ne Q.K.B. shikohet se eshte : Aktiv, Veprimtaria e tij eshte Rrobaqepesi, me mbi 20 vete te siguruar perputhet me objektin e tenderit etj si keto. Atehere cfare document ligjshemrie duhet te paraqes une ?

Kjo pike nuk qendron.

2. Me thone se kur dorezuam mostrat e dyshekeve, nuk dorezuam bashke me mostren skeden teknike origjinale. Skeda teknike eshte ne sistemin elektronik, ai eshte nje dokument i perpiluar nga

prodhuesi i dyshekeve sipas kerkeses se AK-se. Po ashtu eshte dhe autorizimi i prodhuesit dhe plote dokumenta te tjera me vule te njome ne SE.

Kjo pike nuk qendron.

3. Thone se katalogu nuk shpreh qarte tipin dhe permasat e dyshekut qe kerkon AK. Katalogu eshte nje permbledhje e tipeve te dyshekeve qe Subjekti "DEA" shpk, prodhon dhe tregton gjate veprimtarise se saj. Ky subjekt eshte kryesisht eksportues ne vendet perendimore, por dhe prodhues vendi. Prodhuesi "DEA" Shpk, prodhon sipas kerkeseve te klienteve , por nuk do te bej nje katalog enkas per ju. Ai eshte nje subjekt, ndoshta i vetmi ne Shqiperi qe prodhon sipas standartit OEXO TEX dhe AK munde ta verifikonte para vleresimit, por dhe sot, se 2 km large me AK eshte, ne rrugen 5 Maji. Ne kemi etiketen ne dyshek, ku shkruhet qarte se Ofertues eshte subjekti "AN&RA " Shpk, Prodhues eshte "DEA" shpk dhe Certifikaten OEKO = TEX, per prodhuesin e zoteron subjekti "DEA" shpk; dhe 4 flete analizat nga laboratoi i akredituar: 2 per copat e dyshekut (kellefjin), 1 per mbulesen imperabile (padepertueshme nga uji dhe 1 per sfungjerin. Nuk e di se si nuk arrijne te bejne lidhjen ?

Kjo pike nuk qendron

4. Thone se nuk kam sjelle deklarate konformiteti nga prodhuesi per strukturen e dyshekut.

Kete kerkese AK e kishte ne DS para modifikimit dhe e hoqet po vet. Ndaj KVO-ja duhet te azhornohet me DS te modifikuar. Por dhe ne kete rast (para modifikimit) AK kerkonte deklarate konformiteti nga prodhuesi ose edhe Flete analize nga laborator i akredituar. Ne ju kemi sjelle te 4 analizat e laboratorit qe i keni ne SE per gjithë strukturen e dyshekut. Ne menyre te perbeledhur une i them AK-se se vetem hamendeson dhe nuk beni asnje argument me themel qe qendron ne ato qe ata shprehen. Kur une i pyeta ne ankimin tim se: A ka ndonje antar nga KVO-ja qe te me thote se mostra e dyshekut nuk eshte prodhim OEXO TEX, apo carcafet qe ne kemi paraqitur nuk permbushin kerketat tuaja, apo te me provoje ne cdo laborator te botes se ne nuk plotesojme kerketat e AK ? Ata ne pergjigjjen nr.1481/5 date 19.06.2019 me thone : "Sqarojme se KVO ne asnje moment te vlersimit te ofertave, nuk ka thene se, dysheku i paraqitur si moster nga ofertuesi, nuk eshte prodhim OEKO-TEX." Atehere nuk e di se cfare kerkojne. Ata, me kete pergjigje, vet thone se po me skualifikojne kot. Ky arsyetim i tyre u vene kapak te gjithave se asnje nga hamendesimet e AK nuk qendrojne. [...]"

II.8.Në datën 10.07.2019, me anë të shkresës nr.1481/8prot., datë 05.07.2019, ka mbërritur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "AN & RA" sh.p.k., mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen: [...]/1.2 Kriteret e veçanta pika 2.3.9, 2.3.10 operatori ekonomik nuk ka dorëzuar mostrat sipas specifikimeve teknike të autoritetit kontraktor për artikujt e kërkuar: 1.2.1 Artikulli "dyshek krevati për fëmijë" - Është konstatuar se mbi dyshekun e paraqitur si mostër nuk ka asgjë të shënuar,

stampim apo etiketim (me qepje) nga prodhuesi, ku të vërtetohet se ky dyshek është prodhim i prodhuesit “DEA” shpk. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 9, pikat 2.3.9 dhe 2.3.10 “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“Për artikullin:

”Dyshek krevati për fëmijë”

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **fragmente të katalogut** të prodhuesit për produktin e paraqitur si mostër dhe **skedën teknike** të tij.

Të dhënat teknike të përcaktuar në katalog dhe në skedën teknike duhet të jenë në përputhshmëri të plotë me specifikimet teknike të kërkuara.

Fragmentet e katalogjeve duhet të specifikojnë qartë mallrat që do të ofrohen dhe prodhuesin të cilit ato i përkasin.

Në rastin kur katalogu ose skeda teknike janë në gjuhë të huaj, ato duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Për këtë artikull OE ofertues duhet të paraqesë **Deklaratë të Prodhuesit**, ku të jenë përcaktuar qartazi përmbushja e karakteristikave të kërkuara për këtë produkt si dhe të vërtetohet që këto produkte janë të **çertifikuara** për kërkesat e cilësuara në specifikimet teknike.

Për materialin veshës të dyshekut OE duhet të paraqesë:

- Dokumentin e miratimit nga institucione të akredituara dhe të jetë e çertifikuar OEKO-TEX “Lista e Bardhe” Standard 100 per bebe.
- Deklaratë e konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar.

Për strukturën e brendshme të dyshekut OE duhet të paraqesë:

- Deklaratën e konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportet e certifikuar nga laboratorë të njohur të akredituar, për plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara.

Për këllëfin e jashtëm të dyshekut OE duhet të paraqesë:

- Deklaratën e konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportet e certifikuar nga laboratorë të njohur të akredituar, për plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara.

2.3.5 Ditën e hapjes së tenderit, Operatori Ekonomik duhet te paraqesë:

- Nje moster te realizuar sipas specifikimeve teknike te Autoritetit Kontraktor per secilin nga artikujt e kerkuar.

Mostrat do te paraqiten ne daten dhe oren e hapjes se ofertave prane QEZHEF, Rruga e Barrikadave, Çerdhje nr. 1, Tirane.

Mostrat duhet te paraqiten per artikujt e mëposhtëm:

Nr	Emërtimi	Kërkesat e procedurës
1	Çarçaf shtrati i poshtëm (basmë)	1 (një) copë
2	Çarçaf shtrati i sipërm (basmë)	
3	Këllëf jasteku (basmë)	
4	Çarçaf shtrati i poshtëm (fanellate)	Mostër Emri i artikullit, Data e zhvillimit të tenderit,
5	Çarçaf shtrati i sipërm (fanellate)	
6	Këllëf jasteku (fanellate)	

7	Dyshekë krevati për fëmijë	Emrin i prodhuesit/ofertuesit, Nënshkrimi dhe vula e Operatorit Ekonomik
---	----------------------------	---

Mungesa e mostrës është kusht skualifikues.

Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të qepur, e cila të përmbajë të dhënat:

- Mostër
- Emri i artikullit,
- Data e zhvillimit të tenderit,
- Emrin i prodhuesit/ofertuesit,

Nënshkrimi dhe vula e Operatorit Ekonomik.”

III.1.2.Me anë të shtojcës mbi modifikimin e dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka ndryshuar kriteret e mësipërme, si më poshtë vijon:

“Pika 2.3 Kapaciteti Teknik.

Pika 2.3.9, e shtojcës Nr. 9 **“Kapaciteti Teknik”** për **“Blerje materiale të buta dhe dyshekë për fëmijë”**, ndryshon si më poshtë:

Ishte përpara modifikimit:

Për këtë artikull OE ofertues duhet të paraqesë **Deklaratë të Prodhuesit**, ku të jenë përcaktuar qartazi përmbushja e karakteristikave të kërkuara për këtë produkt si dhe të vërtetohet që këto produkte janë **të çertifikuara** për kërkesat e cilësuara në specifikimet teknike.

Për materialin veshës të dyshekut OE duhet të paraqesë:

- Dokumentin e miratimit nga institucione të akredituara dhe të jetë e çertifikuar OEKO-TEX “Lista e Bardhë” Standard 100 për bebe.
- Deklaratë e konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportetet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar.

Për strukturën e brendshme të dyshekut OE duhet të paraqesë:

- Deklaratën e konformitetit të prodhuesit dhe/ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportetet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar, për plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara.

Për këllëfin e jashtëm të dyshekut OE duhet të paraqesë:

- Deklaratën e konformitetit të prodhuesit dhe/ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportetet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar, për plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara.

Bëhet:

Për këtë artikull OE ofertues duhet të paraqesë:

Për materialin veshës të dyshekut OE duhet të paraqesë:

- Dokumentin e miratimit nga institucione të akredituara dhe të jetë e çertifikuar OEKO-TEX “Lista e Bardhë” Standard 100 për bebe ose ekuivalente me të.
- Deklaratë e konformitetit të prodhuesit dhe/ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportetet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar.

Për strukturën e brendshme të dyshekut OE duhet të paraqesë:

- Deklaratën e konformitetit të prodhuesit dhe/ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportetet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar, për plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara.

Për këllëfin e jashtëm të dyshekut OE duhet të paraqesë:

- Deklaratën e konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportet e certifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar, për plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara.

Pika 2.3.10 b), e shtojcës Nr. 9 “Kapaciteti Teknik” për “Blerje materiale të buta dhe dyshekë për fëmijë”, ndryshon si më poshtë:

Pika 2.3.10, b) Për artikullin e paraqitur si mostër:

Ishte përpara modifikimit:

Nr	Emërtimi	Kërkesat e procedurës
1	Dyshek krevati për fëmijë	<ul style="list-style-type: none"> - Skeda Teknike - Pjesë nga katalogu i produktit. - Deklaratë prodhuesi • Për materialin veshës të dyshekut OE duhet të paraqesë: - Dokumentin e miratimit nga institucione të akredituara dhe të jetë e çertifikuar OEKO-TEX “Lista e Bardhe” Standard 100 për bebe. - Deklaratë e konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar. • Për strukturën e brendshme të dyshekut OE duhet të paraqesë: - Deklaratën e konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar, për plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara. • Për këllëfin e jashtëm të dyshekut OE duhet të paraqesë: - Deklaratën e konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar, për plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara.

Bëhet:

Nr	Emërtimi	Kërkesat e procedurës
1	Dyshek krevati për fëmijë	<ul style="list-style-type: none"> - Skeda Teknike - Pjesë nga katalogu i produktit. • Për materialin veshës të dyshekut OE duhet të paraqesë: - Dokumentin e miratimit nga institucione të akredituara dhe të jetë e çertifikuar OEKO-TEX “Lista e Bardhë” Standard 100 për bebe ose ekuivalente me të. - Deklaratë e konformitetit të prodhuesit dhe /ose

		<p><i>prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Për strukturën e brendshme të dyshekut OE duhet të paraqesë:</i> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Deklaratën e konformitetit të prodhuesit dhe /ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar, për plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara.</i> • <i>Për këllëfin e jashtëm të dyshekut OE duhet të paraqesë:</i> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Deklaratën e konformitetit të prodhuesit dhe/ose prodhuesve të lëndës së parë dhe/ose test raportet e çertifikuara nga laboratorë të njohur të akredituar, për plotësimin e specifikimeve teknike të kërkuara.</i>
--	--	---

Argumentimi referuar sugjerimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik:

Deklarata e konformitetit është një dokument ligjor që shoqëron produktet. Duke qenë se, kjo certifikatë i shërben përdoruesit final dhe është e detyrueshme që të shoqërojë produktin deri në destinacionin final, dëshmon plotësimin e specifikimeve teknike të AK nga OE ofertues. Deklarata e konformitetit përmban të dhënat teknike për produktin e kërkuar. Në këtë rast kemi të bëjmë me një dokument, që duhet ta zotërojë i gjithë zinxhiri i distribucionit të produktit, deri te përdoruesi final. Kjo kërkesë vjen në përputhje me Ligjin nr. 10489, datë 15.12.2011 “PËR TREGTIMIN DHE MBIKËQYRJEN E TREGUT TË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE””

III.1.3. Në nenin 23, pika 4, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: “4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin. “

III.1.4. Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur

procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose “

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga ankimuesi në SPE, rezulton se ky i fundit, për produktin objekt prokurimi “Dyshek krevati për fëmijë”, ka paraqitur katalog dhe skedë teknike të dyshekëve të prodhuara nga kompania “Dea” sh.p.k. Nga verifikimi i mostrës për artikullin “Dyshek krevati për fëmijë”, i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “AN & RA” sh.p.k., rezultoi se kjo mostër nuk dispononte asnjë etiketë të qepur (sipas kërkesës të autoritetit kontraktor), markë të stampuar ose të gdhëndur, apo cdo shenjë tjetër identifikuese se, produkti i paraqitur si mostër është prodhuar nga kompania “Dea” sh.p.k. Gjithashtu, nga verifikimi i kryer, Komisioni konstatoi se mostra e paraqitur nuk përputhet vizualisht me asnjë prej produkteve të pasqyruara në katalogun e paraqitur nga ankimuesi në SPE. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatorët ekonomik, ditën e paraqitjes së mostrave pranë autoritetit kontraktor, duhet të paraqesin mostrën e produktit të premtuar në ofertë, si dhe kanë barrën e provës për ta vërtetuar atë. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara. Në rastin konkret, mostra e paraqitur nga ankimuesi për artikullin “Dyshek krevati për fëmijë”, nuk është dorëzuar në përputhje me kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe është e pamundur të vërtetohet lidhja ndërmjet produktit të ofruar në ofertë, për të cilin është paraqitur edhe dokumentacioni përkatës, me produktin e paraqitur si mostër, për shkak të mungesës të etiketës të qepur, apo cdo shenje tjetër identifikuese të prodhuesit. Komisioni thekson se kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës dhe rrjedhimisht ky i fundit do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.7. Në rast se operatori ekonomik ankimues “AN & RA” sh.p.k. do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar

parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimin të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “AN & RA” sh.p.k për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. do të mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ

III.3.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “AN & RA” sh.p.k mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Malbertex” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.3.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.3.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet. Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato

raste kur, operatori ekonomik ankimes edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “AN & RA” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-20011-04-30-2019, me objekt: “*Blerje materiale të buta dhe dyshekë për fëmijë*”, me fond limit 20,937,512.55 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 03.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1167 protokoli Datë 28.06.2019;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha